



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 121, datë 13.07.2023

**MBI DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK  
Z.NJ. ALKETA NGJEÇI DHE Z. SAMI OSMANI**

Në mbështetje të pikës 6 gërma “b” të nenit 48; pika 1, neni 49 të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë mbështetur në raportin e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve në mbledhjen e radhës së këshillit,

V E N D O S I :

1. T’i jepet mandati për Këshill Bashkiak kandidates zj. **Alketa Islam Ngjeçi**, kandidate nga lista shumemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. T’i jepet mandati për Këshill Bashkiak kandidatit z.**Sami Shiqer Osmani**, kandidat nga lista shumemërore të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 14.07.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 182 / prot.

Durrës, më 19.07 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 121 datë 13.07.2023 “Mbi dhënien e mandatit të anëtarëve të Këshillit Bashkiak znj. Alketa Ngjeçi dhe z. Sami Osmani”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

